

Data 04.10.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** Shërbim i ruajtjes me roje private i ambienteve dhe godinave e DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber - Marreveshje kuader me nje operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 2(dy) vjecar (24 muaj)”.

**REF- 22928-10-04-2024**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 37462110-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit: *Vlera e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate gjithe periudhes se marrveshjes kuader* **9.750.000 ( Nente milione e shtateqind e pesedhete mije) leke pa TVSH , ose 11.700.000 (Njembdhjete milion e shtateqind ) leke me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber ka hartuar Preventivin/zerat e shpenzimeve dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike, termat e references dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar;

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike” e vlefshme, miratuar me vendim të DPP se shtetit për nënkategorinë 1.3.A, me veprimtari “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, te ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 75 datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

**2.1.2** Çertifikatë e Titullarit të Subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018.

**Argumentimi:** Në bazë të pikes 1/c, pikes 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.1.3** Çertifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;

**Argumentimi:** Në bazë të pikes 1/c, pikes 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.1.4** Certifikatat e punonjësve të shërbimit, të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për të paktën 5 (pese) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber.;

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Rekomandimin APP & KPP nr.2511 dhe 180 dt. 06.02.2017 mbi menyren e zhvillimit procedures prokurimit per sherbimin privat te ruajtjes fizike; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**2.2.1** Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet e fundit financiare (2021-2022-2023) jo më pak se vlera e perlloritur e kontratës, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlloritur e kontratës”. Bilancet për tre vitet e fundit financiare viti 2021-2022-2023 konforme kërkesave të nenit 41 të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor të pasqyrave financiare" kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e kërkuara në dy vite të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, të ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/a/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, parashikon marzhin minimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlloritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e perlloritur të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët*

*monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit mbi kufirin e lartë, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve minimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros/bilanceve është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 dhe 4, të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe pika 4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit<sup>1</sup>.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ne ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

**2.2.2** Vërtetim nga pushteti vendor (Bashkitë) që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas adresave te regjistruara ne QKB për vitin 2023. Ndërsa për vitin 2024 për afatin e maturimit të detyrimeve vendore në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve. Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, te ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar, dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e

---

<sup>1</sup>Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.2 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme **ne nje vlere jo me te vogel se 40%** e vleres se fondit limit qe prokurohet, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shenohet vlera, afati i perfundimit kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe neni 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne nje vlere jo me te vogel se 40% e vleres se fondit limit qe prokurohet, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të realizuar shërbimin e kërkuar, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne nje vlere jo me te vogel se 40% e vleres se fondit limit qe prokurohet, të

kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvijës së meparshme, se zoterojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të realizuar shërbimin sic është parashikuar nga AK;

**2.3.2** Operatori ofertues duhet të paraqesë Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në RSH” me zonë mbulimi ku të përfshihet objekti i prokurimit (Peshkopi).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

**2.3.3** Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber si dhe Dokumenti i Performances mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik sipas udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 i Ministrisë të Punëve të Brendshme “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë Vendore së Qarkut Diber, jo më vonë se tre muaj nga hapja e ofertave ku jepet informacioni i mesipër i kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 22 ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014, ‘Për shërbimin privat të sigurisë fizike’, të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

**2.3.4** Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim për performancë nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber, lëshuar sipas përcaktimeve të modelit 21 të udhëzimit Nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, ku të përfshijë numrin e punonjësve të certifikuar jo më pak se 5 (pese).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a, b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, të nenit 22, 44, 45 të ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014, ‘Per sherbimin privat te sigurise fizike’, të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij, Udhezimit Ministrit Brendshem Nr. 130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e SHPSF" Kreu V, Menaxhimi i Sherbimeve, germa A, pika 11, 13;

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/certifikatat profesionale të punonjesve lëshuara nga autoritetet kompetente te nevojshem per ruajtjen e objektit ne 1 (nje) vendsherbim për jo më pak se 5 (pese) punonjës.

Gjithashtu operatorët ekonomikë duhet te deshmojne se kanë qender kontrolli me operator, grup të gatshëm ne funksionim ne perputhje me kerkesat e Udhezimit Ministrit Brendshem Nr.130, date 05.03.2018 "Per funksionimin e SHPSF", si dhe ushtrojne veprimtari ne perputhje me kerkesat e legjislacionit në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit që përkohet sipas legjislacionit tatimor me hapjen e tenderit, të shoqëruar me listëpagesat kontributeve të sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025/a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 5 (pese) punonjës shërbimi/roje objekti të çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Diber të siguruar për çdo muaj, drejtuesin teknik dhe administratorin.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor gjatë procedurës, duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (neni 82, pika 2 LPP dhe neni 26, RrPP).*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i vendsherbimeve dhe i punonjësve ne sherbimin te DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber është përlloragitur bazuar ne domosdoshmerin e mbulimit te ketij sherbimi dhe konkretisht:

-Shërbim ruajtje DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber , adresa: Bulevardi “Eles Isufi” Peshkopi, do të sigurohet me një vend shërbimi dhe **4.98 punonjës shërbimi** me sistem 24 orësh (Turni i pare, turni i dyte dhe turni i trete).

Autoriteti Kontraktor referuar rëndësisë së dokumentacionit për ruajtje dhe vendndodhjes /pozicionit të objektit/godines të DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber, ku është administrata dhe gjithë dokumentacioni qëndror fizik dhe elektronik, dhe për këtë qëllim, në kërkesat dhe specifikimet teknike nga ana jonë është përcaktuar ruajtje me një vendroje me tre turne;

Mbi kete baze studimi si dhe eksperiences ndervite eshte percaktuar i domosdoshem numri i vendrojes qe eshte: 1 vendroje me sherbim 24 ore me tre turne (T1+T2+T3), percaktuar ne Udhezimi i Ministrit Bredshem nr.130 date 5.3.2018 “Per funksionimin e SHPSF”;

- 1 vendroje me 4.98 roje (sherbim 24 ore)= 4.98 roje

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues të disponojë 1 (nje) automjet në pronësi apo të marre me qira me kontratë (ku të specifikohet qëllimi dhe afati në pëputhje me objektin dhe afatin e shërbimi të kërkuar), për ndërhyrje në rastë emergjente, të shoqëruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

*Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor gjatë procedurës, duhet të dorëzoj dokumentat provuese për vetedeklarimet që ka bërë në formularin përmbledhes të vetë deklarimit ( neni 26, pika 2/i RrPP)*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion 1 (nje) automjet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.7** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e koston për ofertën e paraqitur. (**Shih Shtojca 1,2 - Sqarime**)



**Argumentimi:** Në bazë të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, dhe nenit 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, VKM Nr. 113, date 01.03.2023 "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kane përgatitur ofertën e tyre duke u bazuar në legjislacionin në fuqi ku të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend roje etj për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### **A. Përshkrimi i vendrojeve:**

Sherbimi do të kryhet në:

- DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber, adresa: Bulevardi “Eles Isufi” Peshkopi, do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (Turni i pare, turni i dyte dhe turni i trete)

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike, kërkohet për 1 (nje) objekt. Vendndodhja e rojeve do jetë brenda territorit/rrethimit të këtij objekti.

Sh.P.S.Fizik të kryhet në zbatim të Ligjit 75/2014, Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018 "Per funksionimin e shërbimit privat te sigurise fizike" si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniformë, pajisje ndërlidhje dhe mjet transporti. Organizimi i shërbimit të bëhet me plan skicimi e dislokimi në vendosjen dhe shtrirjen e shërbimeve. Në vendshërbim të ketë libër shërbimi për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.

Punonjësit e shërbimit të jenë të çertifikuar konform Ligjit 75/2014, gjatë ushtrimit të detyrës punonjësi të jetë i pajisur me uniformën, shenjën dalluese, emblemën, stemën e shoqërisë, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhës, rrip multifunksional, konform Udhëzimit të MB nr.157, datë 01.04.2015 "Për funksionimin e Shpsf", si dhe të kenë kontrata pune me operatorin ekonomik.

Të sigurojë 1 (nje) grup të gatshme me punonjës shërbimi në mbështetje të njërive të shërbimit në terren për ndërhyrjen dhe parandalimin e rasteve të ngjarjeve. Grupi i shërbimit të jetë i pajisur me uniformë, armatim me autorizimin e përdorimit, ndërlidhje, automjet, si dhe pajisje të tjera speciale për nderhyrje në raste emergjence.

Të vërë në dispozicion për sigurimin e objektit, qendrën e kontrollit, të pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi, radioalarmi dhe të ofrojë shërbim/monitorimi 24 orë për menaxhimin e shërbimit.

Të mbulojë të gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objektit, shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera të njohura me ligj.

Kontraktori mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objekte që ruhet nga ana e tij, kur këto vijnë si rezultat i moskryerjes me korrektësi të shërbimit apo mungesës së vigjilencës së rojeve, dhe që vërtetohet nga organet kompetente. Në këtë rast kontraktori detyrohet të bëjë ç'dëmtimin 100% të vlerës së dëmtuar.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Objekti do të merren në dorëzim në momentin e lidhjes së kontratës nga ana e operatorit kontraktues, i cili do të mbajë përgjegjësi për dëmtimin apo vjedhjen e objekteve, pronë e ndërmarrjes.

Numri i punonjësve të shërbimit duhet të jetë **4.98 roje për 1 (një) vend-roje në DSHP (aktualisht NJVKSH ) Diber** . Firma kontraktuese është e detyruar të ruajë objektin e mësipërm me këtë numër rojesh (**4.98 roje**).

Koha e shërbimit do të jetë 24 orë (T1+T2+T3) per DSHP Diber për çdo ditë kalendarike nga e hëna deri të premten dhe 24 orë për ditët e shtuna, të diela dhe festat zyrtare.

Shërbimi do të kryhet për periudhën – **24 muaj i përlogaritur sipas marrëveshjes kuadër.** Firma kontraktuese është e detyruar të informojë drejtuesit e DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber në rastin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit duke mbajtur proces-verbalet përkatëse.

Firma kontraktuese është e detyruar të lejojë kontrolle të autorizuara nga përfaqësuesit e DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber në objektet që janë në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.

Punonjësit e shërbimit detyrohen të kontaktojnë me përfaqësues të DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber sa herë që nevojitet, duke qenë të detyruar të zbatojnë porositë dhe urdhrat e tyre, në kuadër të ruajtjes së objektit.

Kontraktuesi duhet të vërë në dispozicion Qendrën e Kontrollit (sallë operative). Të gjitha shërbimet do të monitorohen 24 orë nga Qendra e Kontrollit (salla operative) e pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi dhe me grup shërbimi (patrullim policor) e cila është e pajisur me uniformë, automjete shpejtlëvizëse, armatim e pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në rast emergjence.

#### Detyrat e punonjësit të shërbimit:

- Punonjësi i shërbimit do të kryejë shërbim sipas planizimit të shërbimit në librin e shërbimit dhe instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
- Punonjësi i shërbimit të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
- Punonjësi i shërbimit të ruajë në gjendje funksionale mjetet e ndërlidhjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;
- Punonjësi i shërbimit të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal në detyrë të miratuar nga Policia e Shtetit, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Punonjësi i shërbimit të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron; të japë informacionin në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit; të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;
- Punonjësi i shërbimit, para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzues dhe për mangësitë e konstatuara njofton përgjegjësin e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit. Punonjësi i shërbimit për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min. para. Punonjësi i shërbimit nuk duhet të largohet nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit të shërbimit.
- Të lejojë kontrolle të autorizuara me shkrim nga drejtuesit e institucionit në objektin që është në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.

- Punonjësi i shërbimit të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim drejtuesit e shoqërise.
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:
  - a-Rregullorja e brendshme
  - b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi I shërbimit.
  - c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
  - d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.
  - e-Numrat telefonikë të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë e përgjegjës të objektit.
  - f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.
  - g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

#### Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Kontraktor.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

#### Detyrat e kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të godines dhe ambienteve rrethuese të DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber ”, , Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj, një vend roje me tre turne (T1+T2+T3).

**Afatet e ekzekutimit: 24 Muaj** (i parashikuar)

#### Vendndodhja e shërbimit:

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve të nevojshme	Afati i lëvrimit
1	3 (T1+T2+T3)	4.98	<u>24 muaj</u> <i>Kontrata/t do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuader me OE të shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 24 muaj.</i>

## **Shtojca 7**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

### **FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**

#### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

Shërbimi që kërkohet Objekti: DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber, adresa: Bulevardi “Eles Isufi” Peshkopi, do të sigurohet me një vend shërbimi dhe 4.98 punonjës shërbimi me sistem 24 orësh (Turni i pare, turni i dyte dhe turni i trete)

Detyrat: **Parandalimi, bllokimi, bashkepunimi me autoritetet e policise se rendit ne rastet e mundshme te vjedhjeve, demtimeve e shkaterrimeve te objekteve, prones dhe te pasurise se DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber, per zbulimin dhe kapjen e autoreve.**

Shpërndarja: DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber , adresa: Bulevardi “Eles Isufi” Peshkopi

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike, kërkohet për 1 (nje) objekt. Vendndodhja e rojeve do jetë brenda territorit/rrethimit të këtij objekti.

Sh.P.S.Fizik të kryhet në zbatim të Ligjit 75/2014, Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr.130 datë 05.03.2018 ”Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike” si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniformë, pajisje ndërlidhje dhe mjete transporti. Organizimi i shërbimit të bëhet me plan skicimi e dislokimi në vendosjen dhe shtrirjen e shërbimeve. Në vendshërbim të ketë libër shërbimi për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.

Punonjësit e shërbimit të jenë të çertifikuar konform Ligjit 75/2014, gjatë ushtrimit të detyrës punonjësi të jetë i pajisur me uniformën, shenjën dalluese, emblemën, stemën e shoqërisë, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhës, rrip multifunksional, konform Udhëzimit të MB nr.157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e Shpsf”, si dhe të kenë kontrata pune me operatorin ekonomik.

Të sigurojë 1 (nje) grup të gatshme me punonjës shërbimi në mbështetje të njësive të shërbimit në terren për ndërhyrjen dhe parandalimin e rasteve të ngjarjeve. Grupi i shërbimit të jetë i pajisur me uniformë, armatim me autorizimin e përdorimit, ndërlidhje, automjet, si dhe pajisje të tjera speciale për nderhyrje në raste emergjence.

Të vërë në dispozicion për sigurimin e objektit, qendrën e kontrollit, të pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi, radioalarmi dhe të ofrojë shërbim/monitorimi 24 orë për menaxhimin e shërbimit.

Të mbulojë të gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objektit, shpenzimet për uniformat, armatime, ndërlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera të njohura me ligj.

Kontraktori mban përgjegjësi për dëmtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në objekte që ruhet nga ana e tij, kur këto vijnë si rezultat i moskryerjes me korrektësi të shërbimit apo mungesës së vigjilencës së rojeve, dhe që vërtetohet nga organet kompetente. Në këtë rast kontraktori detyrohet të bëjë ç' dëmtimin 100% të vlerës së dëmtuar.

#### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Objekti do të merren në dorëzim në momentin e lidhjes së kontratës nga ana e operatorit kontraktues, i cili do të mbajë përgjegjësi për dëmtimin apo vjedhjen e objekteve, pronë e ndërmarrjes.

Numri i punonjësve të shërbimit duhet të jetë **4.98 roje për 1 (një) vend-roje në DSHP** ( aktualisht NJVKSH ) Diber . Firma kontraktuese është e detyruar të ruajë objektin e mësipërm me këtë numër rojesh (**4.98 roje**).

Koha e shërbimit do të jetë 24 orë (T1+T2+T3) per DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber për çdo ditë kalendarike nga e hëna deri të premtën dhe 24 orë për ditët e shtuna, të diela dhe festat zyrtare.

Shërbimi do të kryhet për periudhën – **24 muaj i përlogaritur sipas marrëveshjes kuadër**. Firma kontraktuese është e detyruar të informojë drejtuesit e DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber në rastin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së shërbimit duke mbajtur proces-verbalet përkatëse.

Firma kontraktuese është e detyruar të lejojë kontrole të autorizuara nga përfaqësuesit e DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber në objektet që janë në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.

Punonjësit e shërbimit detyrohen të kontaktojnë me përfaqësues të DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber sa herë që nevojitet, duke qenë të detyruar të zbatojnë porositë dhe urdhrat e tyre, në kuadër të ruajtjes së objektit.

Kontraktuesi duhet të vërë në dispozicion Qendrën e Kontrollit (sallë operative). Të gjitha shërbimet do të monitorohen 24 orë nga Qendra e Kontrollit (salla operative) e pajisur me sistem ndërlidhje, radiokomunikimi dhe me grup shërbimi (patrullim policor) e cila është e pajisur me uniformë, automjete shpejtlëvizëse, armatim e pajisje të tjera speciale për ndërhyrje në rast emergjence.

#### Detyrat e punonjësit të shërbimit:

- Punonjësi i shërbimit do të kryejë shërbim sipas planizimit të shërbimit në librin e shërbimit dhe instruktazhin e nevojshëm nga Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
  - Punonjësi i shërbimit të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
  - Punonjësi i shërbimit të ruajë në gjendje funksionale mjetet e ndërlidhjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;
  - Punonjësi i shërbimit të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal në detyrë të miratuar nga Policia e Shtetit, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
  - Punonjësi i shërbimit të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron; të japë informacionin në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit; të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;
  - Punonjësi i shërbimit, para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzues dhe për mangësitë e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe atë të objektit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit. Punonjësi i shërbimit për marrjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min. para. Punonjësi i shërbimit nuk duhet të largohet nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marrë miratimin e përgjegjësit të shërbimit.
  - Të lejojë kontrollin të autorizuar me shkrim nga drejtuesit e institucionit në objektin që është në ruajtje prej tij dhe nënshkruan në këto raste proces-verbalet përkatëse.
  - Punonjësi i shërbimit të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë me shkrim drejtuesit e shoqërisë.
- 
- Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:
    - a-Rregullorja e brendshme
    - b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi I shërbimit.
    - c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
    - d-Mjete ndriçimi në rast mungese të energjisë elektrike.
    - e-Numrat telefonikë të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë e përgjegjës të objektit.
    - f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.
    - g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.



Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të Autoritetit Kontraktor.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

Detyrat e kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t'ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t'ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.

Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: DSHP ( aktualisht NJVKSH ) Diber, adresa: Bulevardi "Eles Isufi" Peshkopi

**Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga nënshkrimi i MK.**

**Njesia e Prokurimit**